



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 31.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 27.01.2025 të parashtruar nga Operatori Ekonomik Fitorja SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “**Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime**” me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE Fitorja SH.P.K. e datës 27.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime**” me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, të datës 22.01.2025 te publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK, i datës 22.01.2025;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik Fitorja SH.P.K. me datë 27.01.2025 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime**” me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 31.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 2 Fusheveprimi
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**
- Neni 24** - Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
- Neni 27 Dosja e Tenderit
- Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
- Neni 56 -Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 64 Dëshmitë e kërkesave

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet sipas OE ankues:

Te nderuar ne menyre kronologjike duam te iu shpjegojm te gjitha proceduren e tenderimit deri te hapja dhe mbyllja e sajë.

Me datë: 17.10.2024, është shpallur Njoftimi për Kontratë nga ana e Ak-së, dhe me datë: 22.01.2025 keni ngarkuar vendimin me ane te letres B58 Njoftim mbi Vendimin e Autoritet Kontaktues. Dhe ne kete rast keni shpallur si OE fituese OE: "Raf II" shpk me cmimin e ofertuar me vleren: 6,299,996.00 Euro si OE te pergjegjeshme.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli: "Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime"

Nr. i prokurimit: 206-24-187-5-1-1

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1	Grup i Operatorëve Ekonomik B- BARDHI SH.P.K.; VALI INVEST SH.P.K.; Linda, Ferizaj, 70000, Ferizaj	5,477,777.77 €
2	„Raf II”sh.p.k., Xhelal Hajda Toni, 21000, Kosovo	6,299,996.00 €
3	BM Group SH.P.K., VETERNIK, 10000, PRISHTINË	5,855,430.04 €
4	Fitorja SH.P.K., RRE RECAKUT, 70000, FERIZAJ	6,954,511.13 €
5	Grup i Operatorëve Ekonomik ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.; SHM Architecture SH.P.K., ARBËRI NORA E HOTIT,BLL.C2-10,OBJ."B"III-4/2, -, PRISHTINË	5,897,828.23 €
6	Grup i Operatorëve Ekonomik Agri Construction shpk; CONEX L.L.C.; Pepa Group, Rruga e dibres, 1000, Tirane	5,328,431.20 €

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Ministria e Shëndetësisë shpërblen me kontratë, operatorin ekonomik „Raf II”sh.p.k. nga Rahoveci në vlerë te ofertës prej 6,299,996.00 €.

Dhe neve si OE na keni shpallur si te pa pergjegjeshme per arsyet si ne vazhdim:

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar¹

22.01.2025, Prishtinë

Ministria e Shëndetësisë, rr. e Zagrebit nr. 60, ish spitali i mushkërive, lagja Arbri
Fitorja SH.P.K. RRE RECAKUT, FERIZAJ

Nr. i prokurimit	206-24-187-5-1-1
------------------	------------------

Titulli: "Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtimë"

I nderuar z. Maloku,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM

Oferta juaj është e papërgjegjshme për arsyet si në vijim: Nuk e keni plotësuar kriterin e tenderit: ~~Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka kapital financiar në vlerë prej së paku 2 milion Euro për realizimin e këtij projekti (mjete të gatshme në bankë për këtë projekt) ose mbështetje bankare (qasje në kredi - limit të aprovuar nga banka) për realizimin e këtij projekti, në vlerë prej së paku 2 milion Euro. Në rast të grupit min. 60% të plotësohet nga lideri.~~

Sipas Letrës Mbështetëse të ofruar nga BKT, nuk ka limit të aprovuar siç është kërkuar, por kjo mbështetje bankare është vetëm si konfirmim që nëse e fiton projektin, banka është e hapur ta shqyrtoj çdo kërkesë të kompanisë Fitorja SH.P.K. duke u bazuar në politikat e matjes dhe menaxhimit të riskut lidhur me mbështetjen financiare të kompanisë Fitorja SH.P.K. për financimin e projektit...

Kërkesa e NJK dhe DT ka qene e kjar...ose mbështetje bankare (qasje në kredi - limit të aprovuar nga banka) për realizimin e këtij projekti.


Gjithashtu oferta juaj është e pa përgjegjshme edhe sa i përket ofertës financiare, meqenëse keni ofruar me vlerën 6,954,511.13 euro, e cila është për 153,891.37 euro mbi vlerën e parashikuar në tender prej 6,800,619.76 euro.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

~~Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.~~

Me respekt,

Berat Marmullaku
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)

¹ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).

Dhe me ane te kesaj ne pretendojm që është bërë shkelje nga ana e Ak-se, me qellime qe te na eliminoj si te pa pergjegjeshem de mos ta marr ne konsiderat Kriterin si Oferta me e favorshme Ekonomikisht, duke aluduar ne Leter Mbeshtetjen nga banka. Duam te lu njoftojm qe kriteri per kete leter mbeshtetje ka qene si me posht:

<p>Kapaciteti ekonomik dhe financiar</p>	<p>Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2021-2022-2023) ka qenë në vlerë se hashku në të tri vitet jo me pak se 12 milion Euro. Ne rast te grupit min. 60% te plotësohet nga lideri. - Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka kapital financiar në vlerë prej së paku 2 milion Euro për realizimin e këtij projekti (mjete të gatshme në bankë per këtë projekt) ose</p>
	<p>mbështetje bankare (qasje në kredi - limit te aprovuar nga banka) për realizimin e këtij projekti, në vlerë prej së paku 2 milion Euro. Ne rast te grupit min. 60% te plotësohet nga lideri., Dëshmia 1. Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo ne vendin e themelimit te kompanisë, APO Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur. Dëshmia 2. Letër konfirmuese nga banka, dokument origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar.</p>

E cial qartazi thotë : MJETE TE GATSHME APO LIMIT TE APROVUAR NGA BANKA. Dhe me anë te letermbeshtjstjes te cilen e kemi ofruar Banka thot: që në rast te shpalljes fituese te OE FITORJA SHPK. Kemi biseduar qe ne baze te kushteve dhe politikave te bankes do te perkrahim OE FITORJA SHPK per projektin në fjalë. Andaj duam te bëjm me dije qe secila Bank ne Republiken e Kosovës gjithmon duhet të ceke që në baze te politikave dhe ligjeve do e aprovojm. Sepse po te thuhen Ne e aprovojm pa asnjë kushtë athere kjo në nje shpreheje tjter ne popull njohet si FAJDE. Por deri sa të gjitha proceduart shkojn ne perputhje me Rregullat dhe Politikat e seciles bankë ne Republiken e Kosovës të cilat duhet ti respektojn Rregulloret dhe Ligjet nga BQK-ja athere kjo letermbeshteje duhet te eshte valide dhe konfort kërkeses ne DT.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SLLA
Dega Prizriç
Rr. Dëshmorët e Kosovës
Prizriç 70000, Republika e Kosovës
Protokol No. 740/2-2024

Prizriç, 15 Nëntor 2024

Per: **MINISTRINË E SHËNDËTËSISË**
Adresa: Rr. Zogajit No. 60, 10000,
Prishtinë, Republika e Kosovës

Nga: **FTTORJA SHPK**
Adresa: Rruga e Ruzikut, Prizriç

Titulli: Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shitrim

Nr i produktit: 20-24-187-5-1-1

Hekësorja e Ftorja Shpk, me protokol Z. Tërho Shitimi me numër të biletës 810667074, është kthyer i bashkë meqë Kemi Bankën e Prizrit e Kosovës në përputhje me kërkesën e Komitetit Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shitrim, me numër të produktit 20-24-187-5-1-1.

Në këtë rast, meqë Komiteti i Prizrit Shpk, e formuar sipas dispozitivës së parë të Ndërtimit i objektit të ri për Institutin Special në Shitrim, me numër të produktit 20-24-187-5-1-1, Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Shk, mbledhje e hapur të drejtuesve, çka kërkesë të Komitetit Ftorja Shpk, është i mundur të pajtimet e shprehur dhe marrëveshjet me bankën tregtare të bashkëpunimit të kompanisë Ftorja Shpk, për financimin e projektit Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shitrim, me vlerë tërëse të shumës 2,000,000 euro (dy milionë euro), gjatë kohës së kësaj marrëveshjeje të bashkëpunimit nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, procedurave dhe rregullimeve të vendosura të Bankës Kombëtare Tregtare Kosovë Shk.

Dedekësorja të për informim të Bankës Kombëtare Tregtare Kosovë Shk, meqë të bashkëpunimit çka kërkesë informacione që lidhet me qëllimin e pretendimit të kësaj.

Konfirmojmë se jemi bankë e regjistruar në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, e cila njih çdo të bashkëpunimit të Komitetit Prizriç për Veprimet Financiare (FATF).


Jeta Melanić
Menaxher i Dega




Feloni Salihu
Menaxher i Komitetit

Si dhe Pretendimi tjetër i cili është kalimi i Cmimit së vleres se paraprë nuk e kalon mbi 10% te shumes totale dhe si e till pranohet pasi që garancionin ne fazen e tenderimit ne proceduara e kemi mbushur maksimal, dhe me kete cmime te ofruara marrim përgjegjësi 100% per garancionin e ofruar.

Sepse kërkesa ne DT është Tenderi me i Favorshem, dhe jo Cmimi me i ulet:

Kriteret e Dhënies	30.1	Tendeni i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët]; <input type="checkbox"/> apo [Tendeni i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6 <input checked="" type="checkbox"/> Shënim: Kërkohet nga OE qe gjate përgatitje se Formularit te tenderit ne platformën elektronike, te plotësojnë te gjitha nen-kriteret e TEMF: Çmimin dhe periudhën me të gjatë të Garancionit te puneve (min. 2 – max. 5 vite). Mosplotësimi i Formularit te tenderit si duhet do te shpije ne eliminim te ofertes.
--------------------	------	---

Duke u bazuar në te gjitha keto ne e konsiderojm që na është bërë e padrejt gjate vlerismit te Tenderit dhe Vlerimi nuk ka qene ne Harmoni me Rregullat dhe Nenet siq parashihen ne Ligjin e Prokurimit Publik t: Kosovës.

Pas qasjes në dokumnte te Oe te shpallur fituese nga ana e Ak ne kemi hasur ne leshime dhe gabime te cilat OE e shpallur fituese duhet te shpallet si e papergjeshme pasi qe nuk i ploteson Kriteret sipas DTF-se.

Pretendimi 1

Ne dosjen e tenderit kerkohet te jeteë e Obligueshme ANKESI 1

Dhe OE ne fjale nuk e ka perbushur dhe nuk e ka dorezuar fare Deklaraten e Specifikimeve Teknike e cila është e Obligueshme sipas DOSJES SE TENDERTIT:

ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Shenim: AK ka vendosur afatin kohor, konform normave dhe standardeve ndërtimore, si dhe ndarjeve buxhetore, ku është vlerësuar afatit për implementim të këtij projekti max. 24 muaj.

OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, "Planin Dinamik të Detajuar" duke plotësuar Formën Standarde te Planit Dinamik te publikuar si dokument shtese ne eprokurim tek Dosja e Tenderit.

Për secilin pozicion të përshkruar në paramasë duhet të shënohet numri i ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit të caktuar. Planin dinamik duhet te jete konform normave dhe standardeve ndërtimore.

Operatori Ekonomik pas nënshkrimit te kontratës ne kordinim me menaxherin e kontratës te Autoritetit Kontraktues, do të bëjë adaptimin e planit dinamik të dorëzuar sipas datës së planifikuar për fillimin e ekzekutimit të punëve.

Vëmendje: Mbetet obligim i Kontraktorit që, përveç pajisjeve dhe makinerive të listuar më poshtë, të sigurojë edhe pajisje dhe makineri tjera për të cilat kontestohet nga vet Kontraktori se janë të nevojshme për ekzekutimin e punëve proporcionale me natyrën dhe vëllimin e punëve, sasi të, cilësisë së materialeve dhe mjeshtërive si dhe dinamikës së ekzekutimit të punëve të specifikuara.

Sqarim:

Punimet ne objekt duhet te zhvillohen paralelisht ne menyre qe te mos kemi vonesa te panevojshme.

Pretendimi 2

Tek lista e Stafit OE ka Ofruar staf Profesional, por ne mesin e tyre ka Diploma te cilat nuk jan te NOSTIFIKUARA, apo Diploma te cilat nuk jan në gjuhen Zyrtare te cilat Pranohen nga Prokurimi i Kosovës. Andaj cilësojm që Menagjeri i Projektit Z. Milot Muhaxheri. Nuk e ploteson Kriterin sipas dosjes s: tenderit sepse diploma e tij është në një gjuhe e cila nuk është e pranueshme apo standarte dhe as Promre apo sekondare ne Republikën e Kosovës, dhe si e till e njta nuk ka asnjë kopje te Prkthyr nga ndonjë Institucion i Republikës së Kosovës. Ne si te Till e dijm të gjithë që asnje Referenc apo Dokument nuk pranohet nese nuk kan në tri gjuhët Zyrtare te Republikës s: Kosovës.

Edhe Noterizimi i Diplomes se të njetit Igjinier Nuk thuhet qe eshte e vertetuar nga ORIGJINALI, Por nga KOPJA E NOTERIZUAR, e cila len shum dyshimie, dhe si e till është dashur te jete e papergjegjëshme dhe e pa pranueshme per AK-ne. Pasi ne kete rast kemi standarte te dyfishta. Ne mund te iu ofrojm precedete te ndryshme per pranueshmerin e gjuheve tjera kur Ak dhe OSHP ka shpallur si jo valide, një e gjë e till duhet te konsiderohet edhe kjo.



Republika Srbija
Ustav i Republike Srbije

Noi Prof Ing. Giulio Ballo Rettore del

POLITECNICO DI MILANO

con gli studenti degli studi compiuti
voto di risultato delle prove finali superate in questi Politecnico il giorno 14 ottobre 2008
conferiamo a

Milot Muhaxheri

nato a Peja (Serbia) il 28 agosto 1984

LA LAUREA SPECIALISTICA in

Ingegneria Civile

Classe delle lauree specialistiche n. 23/S - Ingegneria Civile

Il presente diploma viene rilasciato a tua giusta istanza di legge.

Milano add. 24 ottobre 2008

Il Rettore

Giulio Ballo

Reg. n. 757

Il Direttore Amministrativo

Il Preside della Facoltà




REPUBLIKA E KOSOVËS
 NOTER
 SEFADIN BLAKAJ, M.A.,
 PRISHTINË

Nr. I LRP-nr/7694/2024

VERËTETIM I DOKUMENTIT KONFORM ME KOPJEN E VERTETUAR

Më nëntë gusht dhjetor e njëzet e katër, para muaje Sefadin Blakaj, Noter në Prishtinë, në rrugën Nr. "Fehmi Agim" Nr. 2193-1, me kërkim dhe në prezencë të Z. Hamdi Terpeza, i lindur me 03 Gusht 1985 në Prishtinë, i identifikuar sipas të dhënave të prezencës: 1500643809, në Këshillin nga MPB e Republikës së Kosovës me datë 11.03.2024 dhe me datë shtator 20.03.2024, me vërbashkësim në Prishtinë, me afërsisht verëtim/veretimet të:

Dokumentit që kërkohet Z. Terpeza që ai kërkohet në një kopje të vërtetuar është shtuar si "DIPLOMË" e datës 17.07.2006, e cila është vërtetuar në noter Zyler Aliu në Lipjan me I.RP.:8609/2023 me datë 26.06.2023, e njëjta përberet nga tre faqe dhe dy foto të njëjti shtetë i vërtetuar në secilin faqe me vlerë të mosvërbashkësimet.
 Ky dokument është shprehur për të njëjtën kopje dhe të dy foto.



Ky dokument është shprehur të njëjtën kopje të vërtetuar i cili nga për të njëjtën prezantuar si kopje e vërtetuar, është fotografuar në këtë rreth të Noterit dhe pas kryeshkrimit është vërtetuar. Noteri nuk ka pasur origjinalin e dokumentit, si dhe kopjimi i të njëjtës është bërë në rreth të Noterit nga kopja e vërtetuar, ndaj të njëjtën Noterit e vërtetuar si kopje identike me kopjen e vërtetuar, të prezantuar nga pala.

Dokumentit e paraqitur nga Z. Terpeza si kopje e vërtetuar, e ka secilë vetë si dhe të njëjtën e shprehur me kopjen e vërtetuar.
 Për të njëjtën kërkim dhe në njëjtën prezencë të cilët mund të nënvizohet me rast të dokumentit që kërkohet të vërtetuar është i përvetësuar i fjalëve.

Ky vërtetim i bashkëngjitur dokumentacionit si kopje e katert dhe Beta e tij e trete.

Verëtim i notetit/veretimit u krye në Prishtinë më nëntë gusht dhjetor e njëzet e katër.
 Shpenzimet për punën e noterit janë paguar në shprehje prej: 3.50 (Trafikimi 29) + 0.60 (Numri 42.1) + 0.50 (numri 42.2) = 4.60 plus TVSH, në përkatësi me datë 05/23 mbi tarifën, numri 29 dhe Numri 42.


NOTERI: Sefadin Blakaj, M.A.:



Pra kerkojm nga Ak qe ta kete parasysh kete dokument dhe te thrras në vertetesin e saj, pasi qe si e till ngjall shum dyshime dhe me te drejt do kerkojm te hetohet si e till.

Pretendimi 3

Njete ne dosjen e tenderit tek kerkesat e stafit , mbi 77% e stafit jan diploma te pa nostifikuara te cilat jan te diplomuar jashte shtetit te Republikës së Kosovës
 Ne si OE konsiderojm qe jemi te Diskriminuar dhe nuk jemi te barabarart ne kete procedur te Prokurimit Publik, dhe kosiderojm qe e gjithë proceduara e tenderimit ka qene shkelje e te gjitha NENEVE te cekuara me larte.
 Mos te harrojme te cekim qe si proceduar Hapja e tenderit ka qenë me datë 18.11.2024 ne ora 14:00
 Dhe nga AK kemi pranuar VENDIM MBI PEZZULLIM te Aktivitetit pasi qe nje OE ka bërë ankes ne OSHP. Ankesa ka ardhur ne ora: 11:55 min me date 18.11.2024


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravlja - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizija Nabavke/Procurement Division

DATE/A:	18.11.2024
PËR/ZA/TO:	Operatorët ekonomik
NGA/OD/TROM:	Berat Marmullaku, Udhëheqës i Div. Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	VENDIM mbi pezullimin e AP "Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtëpi" nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1

Të nderuar,

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë bazuar në ankesën në OSHP të datës 18.11.2024 dërguar nga OJ IDEAL PARTNERS SH.P.K. nga Drenas, i cili paraqitjaht tnik ka bere pyetje sponese e ankerese per rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtëpi" nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1, kundër Njoftimit për kontrakt të datës 17.10.2024, mori këtë

V E N D I M

MBI PEZULLIMIN E AKTIVITETIT TE PROKURIMIT

Titulli "Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtëpi" nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1

Vendimi i dorëzohet:

1. IDEAL PARTNERS shpk
2. Operatorëve ekonomik te interesuar

Me respekt,

Pas Pezullimit ka ndodhur nje rast qum i quditshem e cila eshte ne kundërshtim me qdo rregullore te Prokurimi Publik ne te njeten dite pra me date 18:11.2024 ne ora: 13:16 arrin vendimi qe mund te vazhdoni proceduar e tenderimit pa asnje Vendim te OSHP-se.

Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravlja - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

DATE/A:	18.11.2024
PËR/ZA/TO:	Operatorët ekonomik
NGA/OD/FROM:	Berat Marmullaku, Udhëheqës i Div. Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM për AP "Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtime" nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1

Të nderuar,

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë pas ankesës në OSHP të datës 18.11.2024 dërguar nga OE IDEAL PARTNERS SH.P.K, nga Drenasi, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtime" me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1, kemi proceduar me njoftimin për pezullim të AP.

OE IDEAL PARTNERS SH.P.K, paraprakisht nuk ka bërë pyetje shtuese e as kërkesë për rishqyrtim në AK, por ditën e hapjes ka bërë ankese direkt në OSHP.

Pretendimi i OE në këtë ankese është plotësisht i pa bazuar, qarkullimi lejohet deri në dyfishin e vlerës së projektit, në këtë rast është nën këtë vlerë.

Sh pretendimin si në vijim:

Kërkesa për qarkullim financiar është e madhe në raport me punën në terren

Poashtu, është shkëlur LPP me këtë procedurë me këtë kërkesë.

Poashtu, kërkesa për qarkullim financiar të kompanive pjensarrese në procedurë, është e madhe shumë dhe nuk mund të perballohet në këtë garë.

Bazuar në arsyet e lartcekura, nuk ka baze për prolongimin e aktivitetit, meqenëse edhe sistemi po e lejon dorëzimin e ofertave (ka oferta të dorëzuara në platforme), andaj ju sugjerojmë që të ofertoni sipas afateve të përcaktuara për këtë aktivitet, sot deri në ora 14:00.

Duke na dhënë kohë vetëm 44 minuta për dorëzimin e tenderit pasi që ne tash me e kishim dërguar edhe Sigurimin e Tenderit për ta anuluar. Pra është shkëlur e të gjitha dispozitave vetem e vetem për ta hequr konkurrencën dhe për ta lejuar një OE të cilën konsiderojmë që ishte favorizuese në qdo aspekt.

Pas gjithë kësaj Vendimi i OSHP-se është dhënë me datë 25.11.2024, për një procedurë që tani hapja ishte bërë dhe ofertat ishin pranuar

Andaj ne si OE kërkojmë nga AK që të marrë si të bazuar pretendimet tona dhe të bëjë Korigjimet e kerkuara sipas Rrekullores së KRPP-se dhe gjitha dispozitave të prokurimit Publik

Me këtë vendim tuajin si autoritet kontraktues na keni diskriminuar neve në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë "Autoriteti kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Ju si AK duhet të keni në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit

të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE :FITORJA SHPK

KORIGJOHET , njoftimi për kontratës dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente si OSHP dhe me tej.

Dëmet materiale

Natyrishtë si një OE që merret vetëm me këtë veprimtari ne në këtë procedurë jemi të dëmtuar materialishtë, financiarishtë dhe moralishtë, sepse jemi në mesin e OE të cilët merren vetëm me këtë veprimtari dhe diskriminimi që na është bërë na dëmton shumë dhe vlerat e dëmëve për ne janë mjaft të mëdha.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me kërkesën për rishqyrtim te OE ankues:

Pretendimi i parë se OE i rekomanduar nuk e ka plotësuar Deklaratën e Specifikimeve Teknike, është i pa bazuar ky pretendim, meqenëse sipas Aneksit 1 të DT është kërkuar të plotësohet Plani Dinamik e jo Deklarata e Specifikimeve Teknike.

Per sqarimin tuaj Deklarata e Specifikimeve Teknike kërkohej të aktivitetet e furnizimeve me mallra që nuk mund të deshëmoheshin specifikat me dokument apo që nuk kanë katalog, p.sh.: Furnizim me artikuj ushqimor (molla, banane, mish, produkte qumështi, etj) për këto nuk ka dokument se si të deshëmoheshin andaj në këto raste OE ofertojnë me deklarate për specifikat teknike të kërkuara. Deklarata e Specifikimeve Teknike nuk kërkohej të aktivitetet të cilat kanë përshkrim detaj të punëve apo furnizimeve, meqenëse ato janë të specifikuar si duhet dhe deshëmoheshin me katalogje, broshura, ateste etj dhe nuk ka nevojë për një deklarate të tilla.

Pretendimi i dytë se OE i rekomanduar ka ofruar diploma të pa nostrifikuara, është i pa bazuar ky pretendim, meqenëse në DT nuk është kërkuar nostrifikimi i diplomave. Per inxhinierin Milot Muhaxheri ekziston diploma e noterizuar e Fakultetit të Nderimitarise e Rep. së Kosoves, si Baçelor i Konstruksionit ndersa studimet postdiplomike të kryera në Milano të Italisë diploma e specialistit të Inxhinierise Civile dhe doktoratora për Inxhinieri Strukturale Sizmike e Gjeoteknike, andaj për AK ky inxhinier është i superkualifikuar për kërkesat e këtij tenderi.

Pretendimi i tretë në lidhje me ankesën në OSHP ditën e hapjes dhe njoftimin e dhënë për ofertim, është i pa bazuar ky pretendim, meqenëse siç jeni njoftuar ditën e hapjes një OE (IDEAL PARTNERS SH.P.K. nga Drenasi) ka bërë ankese në OSHP nderkohe që nuk ka bërë fare Kerkese për Rishqyrtim në AK.

Ne e kemi vendosur në sistem njoftimin për pezullim të AP si njoftim për të gjithë OE se një OE ka bërë ankese në OSHP, bazuar në nenin 112 të LPP-se theksohet se:

1. Përveç nëse paneli përkatës shqyrtues nxjerr një vendim tjetër me shkrim dhe përdërisa ta nxjerrë këtë vendim, dorëzimi i një ankese e obligon autoritetin kontraktues që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë ankesa në fjalë.

Njoftimin tjetër për vazhdim me ofertim të OE e kemi bërë menjëherë, bazuar në nenin 109 të LPP-së theksohet se:

1. Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrijë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Me qëllim që OE të mos e ndalin ofertimin e tyre, për ndihmesën tuaj dhe OE tjetër ne e kemi vendosur njoftimin tjetër duke ju sugjeruar që të oferoni sipas afateve të përcaktuara për këtë aktivitet, meqenjëse OE ankues nuk ka bërë kërkesë për Rishqyrtim në AK, andaj ankesa në OSHP nuk është në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe si e tillë nuk mund ta pengoj procesin e ofertimit në këtë aktivitet.

Kompanitë e ndryshme-kolegët e juaj si operator ekonomik po shkaktoni komplikime të pa nevojshme në procedurat e tenderimit, duke bërë ankesa të tilla direkt në OSHP si ajo ankesë atë ditë 2 ore para hapjes, me ç'rast po na vëni në "telashe" neve si zyrtar të prokurimit, që në fazën e hapjes së ofertave po detyrohemi që të procedojmë me njoftime të tilla që mund edhe të krijojnë hutitë dhe keqkuptime procedurale.


Andaj në baze të sqarimeve të lartcekura, ju nuk jeni diskriminuar në këtë procedure meqenjëse keni dorëzuar oferte dhe është e pa ndershme nga ana juaj deklaroni se e gjithë proceduara e tenderimit ka qenë shkelje e të gjitha NENEVE të cekura më lartë, meqenjëse ne si AK-MSh jemi njohës mjaft të mirë të neneve të LPP-së.

Në si AK e kemi në konsideratë nenin 1 të LPP-së, meqenjëse oferta juaj është me e shtrenjta, për 153,891.37 euro mbi vlerën e parashikuar në tender, por edhe është oferte e papergjegjshme se paku për dy pikat e cekura në B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Berat Marmullaku

ZPP, Udhëheqës i Div. të Prokurimit